

20251693692

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Bazuar në nenin 16 paragrafin (8) të Ligjit për Arsimin Profesional dhe Trajnim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 3/25 dhe 74/25), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

R R E G U L L O R E **PËR MËNYRËN E PARAQITJES DHE PËRMBAJTJEN E INICIATIVËS, SI DHE** **KRITERET MË TË PËRAFËRTA PËR DHËNIEN E MENDIMIT PËR INICIATIVËN E** **ARSIMIT DUAL**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e paraqitjes dhe përmbajtja e iniciativës, si dhe kriteret më të përafërta për dhënien e mendimit për iniciativën e arsim dual.

Neni 2

Iniciativa për realizimin e planit mësimor, programit mësimor dhe programit të provimit për kualifikim specifik me aplikimin e arsimit dual, i paraqitet Qendrës për Zhvillimin e Arsimit Profesional (në tekstin e mëtejme: Qendra), më së voni 90 ditë para afatit për dorëzimin e propozimeve për Konkursin për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nëse bëhet fjalë për kualifikim për të cilin është përcaktuar plani mësimor dhe programi mësimor.

Neni 3

Iniciativa e Nenit 2 të kësaj Rregulloreje duhet të përmbajë:

- të dhënat e identifikimit: emri i subjektit juridik (punëdhënësit); numri amë i subjektit (NAS) dhe numri i vetëm tatimor (NVT); adresa dhe selia e regjistruar; kontakti - të dhënat e personit të kontaktit,
- arsyetimi për nevojën për kualifikim të ri ose të ndryshuar: përshkrimi i kualifikimit ekzistues/të ri; arsyet e nevojës për kualifikim të ri/të përshtatur; analiza e tregut të punës; përshkrim i kompetencave; implikime financiare për institucionin; numri dhe data e memorandumit të lidhur për bashkëpunim; numri i aktvendimit të verifikimit të punëdhënësit; inovacioni i kualifikimit,
- nënshkrimi i personit të autorizuar, data dhe vula.

Neni 4

Kriteret më të përafërta për dhënien e mendimit për iniciativën e arsimit dual, janë:

- vendim i marrë për verifikimin e punëdhënësit për realizimin e arsimit praktik për nxënësit, e cila dorëzohet në shtojcë të iniciativës nga neni 2 i kësaj Rregulloreje,
- inovacioni i kualifikimit në përputhje me arritjet e reja teknike dhe teknologjike në nivel lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-11060/1
8.8.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.